



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BUJQËSISË,  
ZHVILLIMIT RURAL DHE  
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE

**PROJEKTI I BURIMEVE UJORE DHE UJITJES**

Projekti Nr. P121186

Kredia Nr.. 8211-AL

**Shpall**

**KËRKESË PËR SHPREHJE INTERESI**

Për shërbimin e konsulencës individuale

**Mbikqyrje teknike (supervizimi), verifikimi dhe validimi i pavarur i përgatitjes së  
Kadastrës së Ujërave GIS  
(Nr. Referencës së prokurimit MEFWA/CS/002a)**

Kjo kërkesë për shprehje interesi është vazhdim i Njoftimit të Përgjithshëm të Prokurimit për këtë projekt, publikuar në faqen e Zhvillimit të Biznesit në 25 Maj, 2010; në Njoftimin e Përgjithshëm, përditësuar në 20 Dhjetor 2012, me referencë në Zhvillimin e Biznesit Nr. WB5260-12/12.

Qeveria e Shqipërisë ka marrë një kredi në shumën ekuivalente 31 milion Euro, nga Banka Botërore, kundrejt kostos së Projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes, dhe synon të aplikojë pjesë të këtij fondi për pagesën e “**Shërbimit të konsulencës për mbikqyrje teknike (supervizimi), verifikimi dhe validimi i pavarur i përgatitjes së Kadastrës së Ujërave GIS**”.

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU) ka nevojë të angazhojë një individ Konsulent Lokal për mbikqyrje teknike të përgatitjes së Kadastrës së Ujërave.

Objektivat e Detyrës

Shërbimi konsiston në dhënie asistencë teknike Drejtorisë së Politikave të Burimeve Ujore në MBZHRAU, për të gjitha çështjet teknike që kanë lidhje me pranimin prej MBZHRAU të Kadastrës së Ujërave GIS, që po zhvillohet nga firma konsulente e kontraktuar nën kontratën nr. MEFWA/CS/002 òPërgatitja e Kadastrës Ujoreö.

Konsulenti do të ofrojë shërbimin e mbikqyrjes teknike (supervizimi), verifikimit dhe validimit të pavarur të përgatitjes së Kadastrës së Ujërave GIS.

Objektivi i punës

Detyra i referohet mbikqyrjes teknike (supervizimit), verifikimit dhe validimit të pavarur të përgatitjes së Kadastrës së Ujërave, e cila do të ngrihet nën kontratën me numër reference MEFWA/CS/002 òPërgatitja e Kadastrës Ujoreò.

Detyrat e Konsulentit individual janë:

- a) Ofrimi i një opinionit teknik të pavarur, për të verifikuar dhe validuar Kadastrën e Ujërave GIS, e zhvilluar dhe ofruar nga firma Konsulente e kontraktuar nga MBZHRAU për këtë qëllim;
- b) Zhvillimi i kriterëve të pranimit për zbatimin e planeve të verifikimit dhe validimit të pavarur për Kadastrën e Ujërave GIS, përfshirë këtu kërkesat në lidhje me performancën dhe/ose kushtet e rëndësishme;
  - Listimi i treguesve të nevojshëm të performancës për të testuar aftësinë vepruese dhe funksionimin e Kadastrës së Ujërave GIS.
  - Testet e nevojshme për verifikimin dhe validimin e pavarur të Kadastrës së Ujërave GIS.
- c) Dhënia e një opinionit teknik mbi Kadastrën e Ujërave GIS të zhvilluar dhe ofruar nga firma Konsulente;
- d) Kryerja e procedurave të pranimit për:
  - Kadastrën e Ujërave GIS që mbulon basenet Seman dhe Drini-Buna.
  - Kadastrën e Ujërave GIS me mbulim kombëtar.
- e) Rishikimi dhe validimi materialeve të trainimit dhe i trainimeve për stafin e Drejtorisë së Politikave të Burimeve Ujore dhe Agjensive të Baseneve Lumore gjatë fazave të ndryshme të ngritjes së GIS.
- f) Përgatitja dhe matja e rezultateve të trainimit nëpërmjet formularëve të vlerësimit.
- g) Rishikimi dhe validimi i manualeve të përdoruesit të përgatitura dhe ofruara nga firma Konsulente (duke iu referuar te dy gjinive).
- h) Verifikimi dhe validimi i kodit të burimit sipas kërkesës së klientit si dhe dokumentacionit mbështetës në fund.
- i) Ofrimi i opinionit teknik mbi punën e kryer.

### Kërkesat për Kualifikim

Shërbimi i konsulencës do të realizohet nga një ekspert konsulent lokal me eksperiencë në zhvillimin, supervizimin, verifikimin dhe validimin e projekteve IT të ngjashëm në institucione publike, private ose në projekte të ngjashëm, me kompleksitet të lartë, me volume të dhenash dhe kërkesa për integrimin e sistemeve.

Inxhinieri Konsulent duhet të ketë:

- minimum 10 vjet eksperiencë si inxhinier sistemesh;
- minimum 10 vjet eksperiencë në manaxhimin e projekteve IT;
- eksperiencë të mëparshme përfshirjeje në projektet GIS (përgatitja dhe zhvillimi i sistemit GIS);
- aftësi manaxhimi projektesh;
- eksperiencë të mëparshme në sisteme software ArcGis;
- diplomë universitare në fusha si inxhinieri telekomunikacioni, inxhinieri elektronike ose inxhinieri ICT.

Konsulenti Inxhinier duhet të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës Angleze. Kandidatët e mundshëm duhet të paraqesin një letër interesi dhe CV të detajuar.

### Raportimi dhe Kohëzgjatja

Rëndësi i jepet raportimit në afat dhe të detajuar. Më poshtë jepen raportet dhe dokumentet që duhet të prodhohen, frekuenca, koha e dorëzimit dhe një përmbledhje e përmbajtjes së tyre. Të gjitha materialet do të dorëzohen në 4 kopje anglisht dhe 4 kopje shqip, elektronikisht dhe të printuara.

<b>Raporti</b>	<b>Data e dorëzimit</b>	<b>Numri i kopjeve</b>
Kriteret e Pranimit përfshirë kërkesat në lidhje me performancën dhe/ ose kushtet e rëndësishme;	1 javë pas firmosjes së kontratës	Raporti në Anglisht dhe Shqip (4 raporte për cdo gjuhë)
Opinionit teknik për të verifikuar, validuar dhe procedurat për pranimin e Kadastrës së Ujërave GIS që mbulon basenet Seman dhe Drini-Buna.	2 javë mbas zhvillimit dhe ngritjes së Kadastrës së Ujërave GIS që mbulon basenet Seman dhe Drini-Buna.	Raporti në Anglisht dhe Shqip (4 raporte për cdo gjuhë)
Rishikimi dhe validimi materialeve të trainimit dhe i trainimeve për stafin e Drejtorisë së Politikave të Burimeve Ujore dhe Agjensive të Baseneve Lumore gjatë fazave të ndryshme të ngritjes së GIS.	2 javë mbas përfundimit të sesioneve të trainimit.	Raporti në Anglisht dhe Shqip (4 raporte për cdo gjuhë)
Rishikimi dhe validimi i manualeve të përdoruesit	2 javë mbas dorëzimit të manualit.	Raporti në Anglisht dhe Shqip (4 raporte për cdo gjuhë)
Opinionit teknik për të verifikuar, validuar dhe procedurat për pranimin e Kadastrës së Ujërave GIS me mbulim kombëtar.	Pas zhvillimit dhe ngritjes së Kadastrës së Ujërave GIS me mbulim kombëtar.	Raporti në Anglisht dhe Shqip (4 raporte për cdo gjuhë)
Verifikimi dhe validimi i kodit të burimit sipas kërkesës së klientit si dhe dokumentacionit mbështetës në fund.	2 javë mbas dorëzimit të kodit të burimit dhe dokumentacionit mbështetës përfundimtar.	Raporti në Anglisht dhe Shqip (4 raporte për cdo gjuhë)
Opinionit teknik mbi punën e kryer dhe mbështetjen në vazhdimësi	2 javë mbas dorëzimit të kodit të burimit dhe dokumentacionit mbështetës përfundimtar.	Raporti në Anglisht dhe Shqip (4 raporte për cdo gjuhë)

Kohëzgjatja e shërbimit të konsulencës do të jetë 12 muaj, dhe angazhimi i konsulentit individual gjatë kësaj periudhe do të jetë 34 ditë.

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave fton individë të kualifikuar të tregojnë interesin e tyre në ofrimin e shërbimeve. Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin një letër motivimi duke treguar pse duhet të konsiderohen për këtë pozicion, Curriculum Vitae dhe referenca, në gjuhën Angleze.

Vëmendja e Konsulentëve të interesuar tërhiqet në paragrafin 1.9 të *Udhezuesit të Bankës Botërore: Përzgjedhja dhe Punësimi i Konsulentëve nën kreditë dhe Grantet e IBRD dhe IDA, botimi Janar 2011*, ku parashtrohen politikat e Bankës Botërore për konfliktin e interesit.

Pëveç kësaj, ju lutemi referojuni informacionit specifik të mëposhtëm për konfliktin e interesit në lidhje me këtë detyrë: Politikat e Bankës kërkojnë që konsulentët të ofrojnë këshilla profesionale, objektive dhe të paanshme dhe gjatë gjithë kohës të mbajnë parasysh interesat e klientit, pa marrë në konsideratë punë për të ardhmen dhe nëpërmjet dhënies së këshillave ata parandalojnë konfliktet me detyrat e tjera dhe interesat e korporatës së tyre. Konsulenti nuk do të punësohet për detyra që janë në konflikt me detyrimet e tyre të mëparshme apo aktuale ndaj klientëve të tjerë, ose mund ti vendosin ata në një pozicion ku mund ta kenë të pamundur të kryejnë detyrën në interesin më të mirë për Huamarrësin.

Konsulenti individual do të përzgjidhet në përputhje me procedurat për përzgjedhjen e konsulentëve individualë të përcaktuara në *Udhëzuesin: Përzgjedhja dhe Punësimi i Konsulentëve nga Huamarrësit e Bankës Botërore, botimi Janar 2011.*

Konsulentët e interesuar mund të marrin informacione të mëtejshme në lidhje me Termat e Referencës në faqen zyrtare të MBZHRAU [www.bujqesia.gov.al](http://www.bujqesia.gov.al) ose në adresën e mëposhtme, nga e Hëna në të Premte, gjatë orarit zyrtar.

**Ilirjan Lame**

**Menaxher Projekti**

**Projekti i Burimeve Ujore dhe Ujitjes**

**Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave**

**Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Nr. 2, kp. 1001 Tiranë, Shqipëri**

**Tel: + 355 4 2226243 - 75191**

**E-mail: [ilirjan.lame@bujqesia.gov.al](mailto:ilirjan.lame@bujqesia.gov.al)**

Shprehja e interesit duhet të dërgohet më shkrim në adresën e mëposhtme:

**Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave**

**Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Nr. 2, kp. 1001 Tiranë, Shqipëri**

**Në vëmendje të: Z. Vojo Bregu  
Sekretar i Përgjithshëm**

Në zarf shkruani titullin e pozicionit për të cilin po aplikoni. Afati i fundit i pranimit të aplikimeve është 01 Shkurt, 2016 ora 11.00.